

Njoftim

Tiranë, më 20 Shtator 2023: Dita e hënë, 18 Shtator 2023, shënoi nisjen e aktivitetit më të madh statistikor, Censin e Popullsisë dhe Banesave 2023.

Më shumë se 5 mijë anketues kanë dalë në terren për të trokitur në dyert e qytetarëve për të grumbulluar informacionin e nevojshëm mbi Popullsinë dhe Banesat në vend!

Roli i anketuesit është i rëndësishëm për të siguruar që të dhënat e Censit të jenë sa më të sakta dhe të besueshme. Këto të dhëna, pasi të grumbullohen, do të përpunohen, analizohen dhe publikohen në formë statistikash zyrtare nga Instituti i Statistikave (INSTAT).

Puna e anketuesit në aktivitetin e Censit është thelbësore dhe ndikon drejtpërdrejtë në suksesin e mbledhjes së të dhënave statistikore.

Do të vlerësonim shumë nëse do të respektoni anketuesit dhe t'i mbështesni që të kryejnë me cilësi punën e tyre.

Respektimi i të drejtës qytetare, privatësisë dhe konfidencialiteti janë angazhim dhe detyrim për INSTAT.

Nisur nga rëndësia mbarëkombëtare e këtij aktiviteti, INSTAT do t'ju mbajë të informuar në vazhdimësi.

Faleminderit,

INSTAT